

URDHËR
Nr.483, datë 3.10.2011

PËR HAPJEN E FAKULTETIT EKONOMIK NË SHKOLLËN E LARTË PRIVATE “ILLYRIA”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.252, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Illyria” të Fakultetit Ekonomik.
 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe shkolla e lartë private “Illyria”.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj